

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A. PEJË**



Zyret Qendrore

Rr. Lekë Dukagjini nr 156

Telefoni:

www.hidrodrini.com

30000 Pejë

039 / 432 355

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i nënshkruari, (*Emri, Mbiemri*) _____, i/e lindur me
(*data e lindjes*) _____ në (*vendi i lindjes*) _____,
numri personal _____ deklaroj se me nënshkrimin e kësaj Deklarate
betohem se i plotësoj kushtet për emërim në pozitën e
_____.

- I. Plotësoj kushtet e kualifikimit sipas Nenit 17.1.
- II. Plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l). Kam përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë, siç është përcaktuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe me Ligjin nr. 05/L-009).

Përkatësisht:

17.1 Një person ka të drejtë të shërbejë si drejtor vetëm nëse i plotëson të gjitha kushtet më poshtë si dhe kushtet për pavarësi dhe përshtatshmëri profesionale të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 17 të këtij ligji:

- a) nuk është dënuar ose vendosur nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës, se ka kryer vepër penale ose civile që përfshin përgënjeshtim, prezantim të rrejshëm, korrupsion, vjedhje, pastrim të parave, përvetësim, keqpërdorim apo ndarje të rrejshme të fondeve, ka qenë i përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare;
- b) nuk është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës
 - i. se është angazhuar në sjellje jo-profesionale,
 - ii. se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale,
 - iii. se ka keq-përvetësuar apo ka keqpërdorur paratë apo burimet publike,
 - iv. se keqpërdorur apo keq-përvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo

- c) nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar; dhe
- d) nuk është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara;

17.2 Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

- a) është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- b) mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;
- c) ka shërbyes në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- d) është ose
 - i. punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të palistuar dhe që konkurron me Ndërmarrjen, ose
 - ii. menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit), ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen;
- e) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- f) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

Veç kësaj, deklaroj që i plotësoj edhe të gjitha kriteret e tjera në konkursin e shpallur.

Çdo përgënjeshtim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e cekur më sipër do të rezultojë me diskualifikim të menjëhershëm dhe nëse është e aplikueshme, largimin e personit nga KRU "Hidrodrini" Sh.A.

Data: _____

Nënshkrimi: _____